

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS "GJEOGRAFI"



Program orientues

Koordinator:
Albana Markja

2024-2025

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	4
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	6
Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar	7
Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML.....	14
Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur	28
Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML	29
Kriteret e vlerësimit të orës mësimore.....	42
Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular	49
Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	51
Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML	59


HYRJE

Në kohën moderne, roli i mësuesit ka pësuar një transformim të ndjeshëm për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë dhe nevojave të nxënësve. Përveç ofrimit të njohurive të lëndës, mësuesit sot kanë për detyrë të zhvillojnë aftësi kritike, krijuese dhe shoqërore të nxënësve të tyre. Ata duhet të jenë fleksibël dhe të përditësuar me zhvillimet më të fundit shkencore dhe teknologjike, duke shfrytëzuar mjete të reja didaktike që e bëjnë të nxënësve më tërheqës dhe efektiv. Teknologjia dhe mjetet digjitale janë bërë pjesë e pandashme e mësimdhënies, duke kërkuar nga mësuesit aftësi të mira në përdorimin e këtyre mjeteve.

Përballë këtyre kërkesave nga mësuesi i gjeografisë kërkohen aftësi të shumëllojshme që shkojnë përtej njohurive akademike. Ai duhet të zotërojë një bazë të gjerë dhe të përditësuar të fakteve gjeografike, duke përfshirë zhvillimet më të fundit shkencore dhe teknologjike. Mësuesi i gjeografisë duhet të jetë në gjendje të interpretojë dhe të shpjegojë fenomene natyrore, sociale dhe ekonomike që ndodhin në botë, duke i lidhur ato me realitetet lokale dhe globale.

Në mësimdhënien bashkëkohore, mësuesi i gjeografisë duhet të përdorë metoda inovative për të angazhuar nxënësve, si përdorimi i teknologjisë informative, hartave digjitale dhe mjeteve të tjera vizuale interaktive. Ai duhet të jetë i aftë të përshtatë mësimin sipas nevojave individuale të nxënësve, duke inkurajuar mendimin kritik dhe analizën e thelluar të temave të ndryshme. Gjithashtu, një mësues i suksesshëm i gjeografisë nevojitet të ketë aftësi komunikimi dhe ndërveprimi të forta. Ai duhet të krijojë një atmosferë bashkëpunuese dhe mbështetëse në klasë, ku secili nxënës ndihet i vlerësuar dhe i inkurajuar të shprehë idetë e veta. Kjo kërkon një përjasje të hapur dhe fleksibile, që merr në konsideratë diversitetin e pikëpamjeve dhe kulturave në klasë. Në këtë mënyrë, mësuesi i gjeografisë jo vetëm që përçon dije, por edhe ndihmon në formimin e qytetarëve të angazhuar dhe të përgjegjshëm globalisht.

Përfshirja e mësuesit të gjeografisë në procesin e testimit për marrjen e kategorive të kualifikimit është e rëndësishme për avancimin e tij në karrierë, pasi siguron një matje të qartë të aftësive dhe rezultateve të tij në mësimdhënie. Në këtë mënyrë ai ka mundësinë të demonstrojë kompetencat e tij pedagogjike dhe përvetësimin e metodave moderne të mësimdhënies. Kjo jo vetëm që i jep atij një bazë të fortë për t'u zhvilluar profesionalisht, por edhe siguron përparimin e tij si dhe garanton cilësinë e edukimit për nxënësve.



Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen:

- për kandidatët e kategorisë “Mësues i kualifikuar”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit me test të informatizuar sipas lëndëve/profileve dhe niveleve përkatëse;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues specialist”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve, vlerësimit që realizohet nëpërmjet orës mësimore të hapur dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës;
- për kandidatët e kategorisë “Mësues mjeshtër”, procesi i kualifikimit kryhet nëpërmjet dosjes së zhvillimit profesional të mësuesve dhe vlerësimit që realizohet nëpërmjet projektit kurrikular në lëndën/profilin dhe nivelin përkatës.

QËLLIMI I PROGRAMIT


Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës gjeografi është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë:

- të gjithë mësuesve të lëndës së gjeografisë në zhvillimin e tyre profesional dhe për marrjen e kategorive të kualifikimit.
- të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është i detyruar dhe i unifikuar, për mësuesit që do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje cilësore, për të përballuar me sukses kërkesat që ka ky proces kombëtar.

Programi ka për qëllim që mësuesi:

- të njohë dhe të zbatojë risitë më të fundit në sistemin arsimor parauniversitar;
- të zotërojë kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e mjedisit të klasës, për shtjellimin e koncepteve, për zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues, për nxitjen e diskutimeve, për përdorin e metodave dhe veprimtarive sipas stileve të të nxënësve; për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve, për përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor përfshirë edhe inteligjencën artificiale, qasjen STEM etj.;
- të tregojë përgjegjëshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të njohë konceptin e gjithëpërfshirjes dhe të demonstrojë përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- të lidhë dhe të aktualizojë konceptet lëndore me prioritet globale që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore, pandemitë, krizat ekonomike, antisemitizmin,



çështjet e barazisë gjinore etj., me qëllim ndërgjegjësimin e nxënësve dhe përgatitjen e tyre për të përballuar sfidat e shoqërisë sot dhe në të ardhmen;

- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca dhe modelet e arsimit të kombinuar;
- të planifikojë dhe të zhvillojë orë mësimi efektive sipas metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe të të nxënit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e programit orientues të kualifikimit të mësuesve është e organizuar në tre kapituj, si më poshtë:

3.1 Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar. Në këtë rubrikë përfshihen, kompetencat profesionale dhe rezultateve e pritshme sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional për realizimin e testit të informatizuar, si edhe modele të pyetjeve për lëndën e gjeografisë në secilin nivel arsimor : *arsim i mesëm i ulët (AMU)* dhe *arsim i mesëm i lartë (AML)*.

3.2 Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për organizmin e orës së hapur mësimore, tre modele orësh mësimore për lëndën e gjeografisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur.

3.3 Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular. Në këtë rubrikë përfshihen kompetencat profesionale për zhvillimin e projektit kurrikular, dy modele projektsh kurrikulare për lëndën e gjeografisë në nivelet arsimore *AMU dhe AML*, si dhe kriteret e vlerësimit të projektit kurrikular.

Përmbajtja e programit orientues për testimin e informatizuar

Testi i informatizuar i vlerësimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

- a) Pjesa e parë përmban, zbatimin e programeve përkatëse lëndore dhe planifikimin e lëndës, mjedisin e të nxënit, metodologjitë efektive të mësimdhënie - nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, vlerësimin dhe arritjet e nxënësve, aspekte të etikës dhe komunikimit të mësuesit në institucionin arsimor parauniversitar në mjediset e institucionit, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- b) Pjesa e dytë përfshin aspekte të zbatimit të përmbajtjes shkencore të lëndës në situata praktike nga jeta reale.

Programi i testimit të informatizuar është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- programe lëndore të gjeografisë;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës së gjeografisë;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të gjeografisë.

Në fushat kryesore të zhvillimit profesional përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË GJEOGRAFISË”

Kompetenca

“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjeografisë në shkollë”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i gjeografisë:

- zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;
- përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;
- përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;
- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;
- harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit;
- kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;
- tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të gjeografisë);

- Korniza kurrikulare, 2014
<https://www.ascap.edu.al/korniza-kurrikulare/>
- Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX.
<https://www.ascap.edu.al/kurrikula-berthame-per-arsimin-e-mesem-te-ulet/>
- Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII.
<https://www.ascap.edu.al/kurrikula-berthame-x-xII/>
- Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.
<https://www.ascap.edu.al/kurrikula/>

- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e synimeve dhe rezultateve të programit;
- siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjeografisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale.

FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”

Kompetenca I

“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjeografisë”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i gjeografisë:

- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;
- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;
- identifikon nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar);
- planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;
- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së gjeografisë;
- motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;

- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS.
[https://www.ascap.edu.al/korniza-e-vlerësimit-të-nxënësit-në-arsimin-parauniversitar/](https://www.ascap.edu.al/korniza-e-vleresimit-te-nxenesit-ne-arsimin-parauniversitar/)
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjeografisë në arsimin e mesëm të ulët.
[https://www.ascap.edu.al/udhëzues-lëndorë/](https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendorë/)
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë.
[https://www.ascap.edu.al/udhëzues-lëndorë/](https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendorë/)

- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; - punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.	Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz. https://www.ascap.edu.al/udhezues-per-kurrikulen-me-zgjedhje-ne-gjimnaz/
--	---

Kompetenca II

“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e gjeografisë”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i gjeografisë:

- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;
- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;
- planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;
- përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik e krijues të nxënësve;
- përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;
- dallon llojet e ndryshme të pyetjeve në një test;
- identifikon gabimet në një pyetje objektive;
- demonstron teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;
- përdor pikëzimin korrekt të pyetjeve në një test;

- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm).
<https://www.ascap.edu.al/nivelet-e-arritjes/>
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjeografisë në arsimin e mesëm të ulët.
<https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendorë/>
- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë.
<https://www.ascap.edu.al/udhezues-lendorë/>
- Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP, Lënda: gjeografi.
- Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP, Lënda: Gjeografi.
<https://www.ascap.edu.al/wp->

realizon konvertimin në notë të pikëve të një testi.	content/uploads/2021/11/Gjeografi-3.pdf
--	---

Kompetenca III

“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në gjeografi”

Literatura e rekomanduar

Rezultatet e pritshme

Mësuesi i gjeografisë:

- prezanton materiale gjeografike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel dhe Word;
- përdor platforma online për zhvillimin e koncepteve gjeografike;
- nxit nxënësit të bëjnë prezantime në gjeografi duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;
- përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së gjeografisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website.

- Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
- Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP.
- Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së gjeografisë që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.

FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”

Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i> - njih rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; - sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.	- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. - Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. - Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar. https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/SPFPFLMSAP.pdf

FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”

Kompetenca	Literatura
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”	
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i gjeografisë:</i>	Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

- njeh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.

FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”

Kompetenca

“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së gjeografisë”

Literatura e rekomanduar

Mësuesi i gjeografisë:

- dallon dhe shpjegon konceptet kryesore me të cilat operon lënda e gjeografisë;
- interpreton lidhjet shkak-pasojë midis proceseve e dukurive që trajton kjo lëndë;
- demonstroi lidhjen midis njohurive të lëndës me njohuritë e disiplinave të tjera brenda fushës ose jashtë saj;
- tregon përmes shembujve lidhjen e njohurive të kësaj lënde me situata të jetës së përditshme.
- shpjegon dhe interpreton konceptet, fenomenet dhe informacionin që trajtohet në lëndën e gjeografisë në klasat VI-IX dhe X-XII.

- Programe dhe tekste të lëndës së gjeografisë për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës së gjeografisë për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.

Modele të pyetjeve për secilin nivel arsimor AMU dhe për AML

Model pyetjesh të lëndës “Gjeografi”, AMU

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Programet mësimore të gjeografisë mbështeten në parime të mirëfillta të integritit. Rezultatet e të nxënit të tematikave të programit sigurojnë lidhjen e lëndës së gjeografisë me lëndët e tjera, brenda dhe jashtë fushës “Shoqëria dhe mjedisi”. Rezultati i të nxënit “Nxënësi llogarit mesataren ditore, mujore dhe vjetore të temperaturave të ajrit” mundëson integrimin e lëndës së gjeografisë me:

- A) Qytetarinë
- B) Gjeografinë
- C) Kiminë
- D) Ekonominë

Pyetja 2

Mësuesi/ja gjatë planifikimit vjetor, orët e parashikuara në program për çdo nën tematike i:

- A) respekton rigorozisht;
- B) ndryshon me urdhër të ZVA-së;
- C) ndryshon me +/- 10%;
- D) ndryshon me urdhër të drejtorit.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetje 3

Qarkoni përgjigjen e saktë.

Planifikimi i rezultateve të të nxënit në planin ditor shoqërohet dhe me vlerësimin e tyre, bazuar në nivelet e arritjes. Cili nga rezultatet e të nxënit, të renditur më poshtë, është përcaktues për nivelin e tretë të arritjes?

- A) Identifikon elementet morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve.
- B) Përshkruan elementet morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve.
- C) Llogarit elementet hidrologjike të lumit pa analizuar rezultatet.
- D) Llogarit elementet hidrologjike të lumit dhe analizon rezultatet.

Pyetje 4

Bën pjesë në pyetjet subjektive:

- A) pyetja me zëvendësim të fjalëve;
- B) pyetja me alternativa;
- C) pyetja me kombinime;
- D) pyetja e strukturuar.

Pyetje 5

Cila nga situatat e mëposhtme e nxit nxënësin më shumë të krijojë lidhje ndërmjet njohurive gjeografike dhe jetës së tyre të përditshme.

- A) Për të kuptuar më mirë dukurinë e eklipsit diellor u kërkoni nxënësve të gjejnë informacione nga interneti.
- B) Që nxënësit të njihen më mirë me dukurinë e eklipsit u kërkoni atyre të pyesin prindërit.
- C) Para se të jepni detyrën i pyesni nëse ata kanë parë ndonjëherë eklipsin e diellit në jetën reale ose në një dokumentar televiziv.
- D) U kërkoni të gjejnë foto të eklipsit të diellit në revista dhe libra të ndryshëm.

Pyetje 6

Vlerësimi i vazhduar quhet ndryshe:

- A) vlerësim përmbledhës;
- B) vlerësim periodik;
- C) vlerësim formues;
- D) vlerësim përfundimtar;

Pyetja 7

Programi i gjeografisë përcakton rezultatet e të nxënit për kompetencat lëndore. Cilën nga kompetencat lëndore zhvillon rezultati: “Zgjedh burimet më të përshtatshme nga tërësia e burimeve parësore dhe dytësore në dispozicion”

Marrja e vendimeve.

Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.

Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.

Interpretimi i dukurive gjeografike.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 8

Një klasë gjithëpërfshirëse është ajo ku:

- A) Vlerësimet përsëriten derisa çdo nxënës të arrijë rezultatet minimale.
- B) Mësuesit japin mësim duke iu referuar vetëm tekstit mësimor për të pakësuar ngarkesën e nxënësve.
- C) Ka një përfshirje aktive të nxënësve me rezultate të larta.
- D) Mësuesit krijojnë për çdo nxënës praktika dhe përvoja të ndryshme të nxëni.

Pyetja 9

Në një klasë ku ka nxënës me vështirësi në të nxënë, mësuesi:

- A) Vendos të njëjtat rezultate të nxëni për të gjithë nxënësit e klasës, por realizon punë të diferencuar me nxënës të ndryshëm.
- B) Përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel më të ulët arritjesh.
- C) Vendos rezultate të nxëni të ndryshme për nxënës të ndryshëm.
- D) Përqendron punën dhe fokusohet vetëm te nxënësit me nivel të lartë arritjesh.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 10

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Parlamenti i Nxënësve të Shqipërisë
- B) parlamenti i nxënësve të shqipërisë
- C) parlamenti i nxënësve të Shqipërisë
- D) Parlamenti i nxënësve të Shqipërisë

Pyetja 11

Qarkoni alternativën ku fjala është shkruar saktë.


- A) Institucion arsimor
- B) Institucionë arsimorë
- C) Institucion arsimor
- D) Institucion arsimor

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 12

Një ndër objektet e studimit të gjeografisë ekonomike është:

- A) struktura gjeologjike
- B) kufijtë
- C) bujqësia
- D) hidrografia



Pyetja 13

Një nga pjesët përbërëse të relievit nënujor është:

- A) lugina
- B) platforma kontinentale
- C) rrafshnalta
- D) ultësira

Pyetja 14

Instrumenti që përdoret për matjen e sasisë së rrezatimit diellor quhet:

- A) barometër
- B) heliograf
- C) fluger
- D) termometër

Pyetja 15


Deti i Vdekur, që shtrihet në Azinë Jugperëndimore, emërtohet kështu për shkak të:

- A) thellësisë së madhe dhe mungesës së dritës;
- B) pranisë së madhe të organizmave të vdekur;
- C) ekzistencës së algave helmuese;
- D) sasisë së madhe të kripës.

Pyetja 16

Liqeni i Prespës në vendin tonë ka origjinë:

- A) tektonike
- B) tektoniko-karstike
- C) karstike
- D) akullnajore



Pyetja 17

Është pjesë e trashëgimisë kulturore botërore:

- A) Manastiri i Deçanit
- B) Manastiri i Ardenicës
- C) Xhamia e Plumbit
- D) Xhamia e E'them Beut

Pyetja 18

Zona Patos-Marinëz në Shqipëri dallohet për nëntokë të pasur me:

- A) bitum
- B) hekur-nikel
- C) naftë e gaz natyror
- D) krom

Pyetja 19


Në cilin nga malet e vargjeve të Skënderbeut zhvillohet dukshëm veprimtaria karstike?

- A) Malin e Skënderbeut
- B) Malin me Gropa
- C) Malin e Dajtit
- D) Malin e Velës

Pyetja 20

Shqipëria gjendet në perëndim të Ballkanit dhe në juglindje të Evropës. Në këtë mënyrë është përcaktuar:

- A) Vendndodhja relative.
- B) Vendndodhja absolute.
- C) Karakteristikat fizike të vendit.
- D) Karakteristikat humane të vendit.



Pyetja 21

Cila nga karakteristikat e mëposhtme është e vërtetë për Alpet Shqiptare?

- A) Janë formuar në një strukturë sinklinale.
- B) Kanë drejtim kryesisht veriperëndim – juglindje.
- C) Shtrihen deri në lartësinë 1800 m mbi nivelin e detit.
- D) Kanë përhapje më të madhe shkëmbinjtë gëlqerorë.

Pyetja 22

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë për Rajonin Jugor?

- A) Rajoni Jugor dallohet për një hidrografi të varfër sipërfaqësore.
- B) Rajoni Jugor dallohet për ndërtim gjeologjik të ndërlikuar.
- C) Në Rajonin Jugor mbizotëron bregdeti i tipit të ulët, me plazhe ranore.
- D) Në Rajonin Jugor mbizotëron drejtimi veriperëndim-juglindje i formave të relievit.

Model pyetjesh në lëndën e “Gjeografisë”, AML

A. Programi lëndor

Pyetja 1

Lidhja e gjeografisë me historinë i shërben nxënësit për të:

- A) zhvilluar aftësitë dhe shprehjet e tij komunikuese;
- B) parë botën si një bashkësi globale dhe të ndërruar;
- C) kuptuar më mirë vendin e tij dhe ndryshimet përgjatë kohërave;
- D) reflektuar mbi pasojat e ndikimit të njeriut në çështje të shëndetit.

Pyetja 2

Tregoni cila nga kompetencat e mëposhtme NUK bën pjesë në kompetencat lëndore të programit të gjeografisë:

- A) Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike.
- B) Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit.
- C) Analiza shkak-pasojë e faktorëve të ndryshëm.
- D) Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit të mbledhur.

B. Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë

Pyetja 3

Planifikimi i rezultateve të të nxënësit në planin ditor shoqërohet dhe me vlerësimin e tyre, bazuar në nivelet e arritjes. Cili nga rezultatet e të nxënësit, të renditur më poshtë, është përcaktues për nivelin e tretë të arritjes?

- A) Identifikon elementet morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve.
- B) Përshkruan elementet morfologjike të lumit dhe veçoritë e regjimit hidrologjik të lumenjve.
- C) Llogarit elementet hidrologjike të lumit pa analizuar rezultatet.
- D) Llogarit elementet hidrologjike të lumit dhe analizon rezultatet.

Pyetja 4

Një test është i besueshëm, kur:

- A) pjesa më e madhe e pyetjeve është e nivelit të lartë;
- B) përmban vetëm pyetje me alternativa;
- C) zbatohen kritere të ndryshme vlerësimi për nxënësit;
- D) sigurohen të njëjtat kushte testimi për nxënësit.

Pyetja 5

Cila nga situatat e mëposhtme e nxit më shumë nxënësin të krijojë lidhje ndërmjet njohurive gjeografike dhe jetës së tyre të përditshme?

- A) Për të kuptuar më mirë dukurinë e eklipsit diellor u kërkon nxënësve të gjejnë informacione nga interneti.
- B) Që nxënësit të njihen më mirë me dukurinë e eklipsit u kërkon atyre të pyesin prindërit.
- C) Para se të jepni detyrën i pyesni nëse ata kanë parë ndonjëherë konkretisht eklipsin e diellit ose në një dokumentar televiziv.
- D) U kërkon të gjejnë foto të eklipsit të diellit në revista dhe libra të ndryshëm.

Pyetja 6

Stuhi mendimi është një teknikë, e cila përdoret :

- A) për t'i bërë nxënësit të jenë të vëmendshëm gjatë leximit të një teksti;
- B) për të nxitur dhe për të përfutur shumë ide për një temë;
- C) për të parashikuar rreth asaj që do të ndodhë më tej në histori;
- D) për të shkruar një tregim, duke u bazuar në disa terma kyç.

C. Aspekte të komunikimit dhe etikës

Pyetja 7

Diversiteti social, larmia etnike dhe kulturore në komunitetin e një klase apo shkolle duhet të shihet si:

- A) burim konfliktesh ndërmjet nxënësve;
- B) situatë e përkohshme që nuk duhet vlerësuar;
- C) vlerë që duhet të vlerësohet, të zhvillohet dhe të ruhet;
- D) problem që duhet të zgjidhet me strategji të posaçme.

Pyetja 8

Mënyra më e mirë për të rritur shanset për edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara për të arritur potencialin e tyre të plotë, është:

- A) fokusimi në dobësitë e këtyre nxënësve;
- B) mbajtjen e një pritshmërie të lartë nga nxënës të tillë;
- C) mësimin e një sërë aftësish dhe strategjish që këta nxënës mund ti zbatojnë në një sërë kontekstesh të jetës së përditshme;
- D) inkurajimi i këtyre nxënësve për të përcaktuar qëllimet e tyre.

D. Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Pyetja 9

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- B) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të ministrit.
- C) Procedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me udhëzim të Ministrit.
- D) Proçedurat për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje përcaktohen me Udhëzim të Ministrit.

Pyetja 10

Cila nga alternativat e mëposhtme është shkruar saktë?

- A) Temperatura në det e në tokë është e ndryshme.
- B) Temperatura në Det e në Tokë është e ndryshme.
- C) Temperatura në det e në Tokë është e ndryshme.
- D) Temperatura në Det e në tokë është e ndryshme.

E. Përmbajtja shkencore e lëndës

Pyetja 11

Si paraqiten meridianët dhe paralelet në projeksionin cilindrik?

- A) Paralelet dhe meridianët janë vija të drejta që formojnë kënd 90° .
- B) Paralelet janë në formë harqesh, ndërsa meridianët vija të drejta.
- C) Meridianët dhe paralelet janë rrathë bashkëqendrore.
- D) Meridianët janë vija të drejta që dalin nga një pikë, ndërsa paralelet rrathë.

Pyetja 12

Reshjet atmosferike që formohen nga ngritja e detyruar e ajrit nëpër shpatet apo pengesat malore, quhen:

- A) konvektive
- B) advektive
- C) frontale
- D) orografike.

Pyetja 13

Cila është rëndësia e ozonit për jetën në Tokë?

- A) Thith rrezet infra të kuqe.
- B) Thith rrezet ultravjollcë.
- C) Mundëson transmetimin e valëve të radios.
- D) Mundëson dukuritë meteorologjike në Tokë.

Pyetja 14

Për cilin nga rajonet e Evropës është karakteristikë mbizotërimi i maleve me moshë të re (orogjeneza alpine)?

- A) Evropën Veriore.
- B) Evropën Jugore.
- C) Evropën Lindore.
- D) Evropën Perëndimore.

Pyetja 15

Në disa nga shtetet e Evropës si Spanjë, Belgjikë e Danimarkë forma e qeverisjes është monarki parlamentare. Në disa shtete të tjera si Shqipëria e Italia organizimi shtetëror është republikë parlamentare, ndërsa në Francë republikë presidenciale. Mbështetur në këto fakte cili kriter diferencon këto shtete?

- A) fizik
- B) ekonomik
- C) kulturor
- D) politik.

Pyetja 16

Termi që përshkruan prirjen e mbivlerësimit dhe të epërsisë së një grupi etnik ndaj grupeve të tjera është:

- A) etnocentrizëm
- B) multikulturalizëm
- C) akulturim
- D) difuzion kulturor.

Pyetja 17

Rajoni perëndimor i Shqipërisë dallohet për pasuritë e:

- A) naftës dhe gazit natyror;
- B) hekurit dhe nikelit;
- C) kromit dhe bakrit;
- D) boksideve.

Pyetja 18

Sa për qind të popullsisë së përgjithshme zënë pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë:

- A) 1%
- B) 2%
- C) 3%
- D) 4%

Pyetja 19


Lartësia më e madhe e relievit në Republikën e Kosovës arrihet me:

- A) Malet Qendrore
- B) Pashtrikun
- C) Bjeshkët e Namuna
- D) Gollakun.

Pyetja 20

Bazuar te grafiku i dhënë, kufiri i borës së përhershme është më i lartë në zonat me gjerësi:


- E) Polare
- F) Subpolare
- G) Mesatare
- H) Tropikale.



Pyetja 21

Harta e mëposhtme është paraqitur nëpërmjet projeksionit:

- A) Merkator
- B) Cilindrik
- C) Azimutal
- D) Konik.



Pyetja 22

Cila nga njësitet e mëposhtme fiziko-gjeografike përfaqëson një horst?

- A) Lugina e Shkumbinit të Sipërm.
- B) Malësia e Dangëllisë.
- C) Fushëgropa e Korçës.
- D) Mali i Thatë.

Përmbajtja e programit orientues për orën mësimore të hapur

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve praktike etj. Përpos kësaj, që nxënësit të zotërojnë kompetencat, duhet të përvetësojnë konceptet dhe të zotërojnë shprehitë. Të dyja këto kushte diktojnë nevojën për strategji të ndryshme të mësimdhënies gjatë orës mësimore, të cilat përmbushin rezultatet e të nxënësve dhe përshtaten me stilet e të nxënësve.

Një mësimdhënie - nxënie e mirë menduar dhe e mirë planifikuar, si dhe një mjedis të nxënësve efektiv krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësve. Kompetencat janë të ndërlidhura dhe zhvillohen në vazhdimësi nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Nxënësit janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, ndërtime ose simulime të njohurive dhe të aftësive, si dhe në krahasime rezultatesh apo nxjerrje konkluzionesh. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një mjedis dhe atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre.

Programi orientues për mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit përmban model ore mësimore për AMU-në dhe për AML-n si dhe kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur.

Model ore mësimore për secilin nivel AMU dhe AML

Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin vetë temën, klasën, metodat, teknikat, mjetet, veprimtaritë sipas stileve të të nxënës, instrumentet e vlerësimit etj., që do të përdorin gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur.

A. Model 1 ore mësimore në lëndën e “Gjeografisë” AMU

Klasa 7

Tema mësimore: Lëvizja e ujit të deteve dhe oqeanëve

Rezultatet e të nxënës:

Nxënësi:

- bën dallimin ndërmjet lëvizjeve të ndryshme të ujërave të oqeanëve e deteve dhe faktorët që ndikojnë;
- skicon në hartë drejtimin e lëvizjes dhe rrugën që ndjekin disa nga rrymat oqeanike përmes përdorimit të TIK-ut;
- përshkruan rolin e rrymave oqeanike në klimën e rajoneve që përshkojnë.

Situata e të nxënës:

Përmes një materiali të prezantuar në video prezantohen situata rasti në të cilat paraqiten valë të madhësive të ndryshme në lloje të ndryshme bregdetesh, në kushte të ndryshme moti.

Fjalë kyçe: Valë detare, baticë, zbaticë, tsunami, rrymë e ngrohtë, rrymë e ftohtë

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, hartë e rrymave oqeanike, video, foto, video projektor, kompjuter/laptop, enë me ujë, tharëse flokësh.

Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare: Fizikë, TIK, Histori, zhvillimi i qëndrueshëm.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Organizimi i orës së mësimi:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve


Nxënësve u shfaqen me projektor foto dhe video të shkurtra që demonstrojnë lëvizjen e ujit të detit e të oqeanit dhe u kërkohet t'i emërtojnë këto lëvizje si dhe të listojnë nga dy-tre veçori për secilën.

Nxënësit nxiten të diskutojnë për përvojat e tyre, të përjetuara nga ata kur kanë shkuar pranë detit ose përvoja të tjera nga filma, filma dokumentarë etj., për valët detare, madhësinë e tyre, ndikimin e kushteve të motit etj. Mësuesi bën kujdes të nxisë imagjinatën dhe kuriozitetin e fëmijëve me fakte dhe ngjarje interesante që lidhen me këto dukuri natyrore.

Për të nxitur më tej diskutimin me nxënësit, mësuesi u drejton disa pyetje të shkurtra që mbështesin diskutimin dhe zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë:

- Përse lëviz uji i deteve dhe i oqeanëve?
- Po ju, keni parë në bregdet valë të mëdha detare?
- Si mendoni, kush i ka shkaktuar?
- Renditni disa nga shkaktarët e valëve detare;

- Si emërtohen valët që shkaktojnë tërmetet në oqeanë?



Ndërtimi i njohurive të reja

Klasa organizohet të punojë në grupe. Krijohen 3 grupe nxënësish dhe secilit grup i caktohet një detyrë e veçantë për një nga llojet e lëvizjeve:

Grupi 1: Valët detare

Grupi 2: Baticat dhe zbaticat

Grupi 3: Rrymat oqeanike

Valët detare

Baticat e zbaticat

Rrymat oqeanike

- Grupi i parë i nxënësve punojnë për valët detare. Mësuesi zhvillon një demonstrim për të cilin diskutojnë së bashku me nxënësit. Në një enë të gjerë me ujë dhe me një tharëse flokësh demonstron ndikimin e erës në sipërfaqen e ujit. Mësuesi zhvendos tharësen e

flokëve për të gjetur largësinë dhe këndin më të mirë për të krijuar valë mesatare.

Ndërkohë demonstrimi shoqërohet me pyetje:

- Si bëhen valët kur e rrisim shpejtësinë?
- Si ndikon këndi i fryrjes së erës mbi madhësinë e valëve?
- Grupi i dytë i nxënësve punon për baticat dhe zbaticat.



Paraprkishtë mësuesi ka mbledhur informacion të shoqëruar me foto të cilin e vendos në dispozicion të nxënësve. Nxënësit diskutojnë për shkaqet e formimit të tyre dhe pasojat. Duke sjellë shembuj nga përvojat e tyre në plazhe, nxënësit sjellin në vëmendje kohën kur baticat dhe zbaticat ndodhin.

- Grupi i tretë i nxënësve punon për rrymat oqeanike. Mësuesi paraprkishtë ka identifikuar në internet hartën e shpërndarjes së rrymave oqeanike. Nxënësit në kompjutera përcaktojnë në harta përmes lëvizjes së kursorit drejtimin që ndjekin rrymat e ngrohta dhe rrymat e ftohta, identifikojnë rajonet ku këto rryma kalojnë duke nxjerrë konkluzione për ndikimin në klimën e këtyre rajoneve.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në përfundim të punës në grupe, secili grup prezanton para klasës gjetjet, ndërkohë që mësuesi plotëson dhe saktëson përgjigjet e nxënësve, sikurse nxënësit plotësojnë përgjigjet e njëri-tjetrit.

Vlerësimi i nxënësve:

Për vlerësimin e nxënësve do të përdoren:

Përgjigjet me gojë, vëzhgimet e drejtpërdrejta gjatë punës në grup dhe individuale, vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri.

Niveli 2

Nxënësi:

- Identifikon llojet e lëvizjeve të ujërave të deteve dhe oqeanëve; Dallon në hartë rrymat oqeanike.

Niveli 3

Nxënësi:

- Përshkruan llojet e lëvizjeve të ujërave të deteve dhe oqeanëve dhe identifikon një ndër faktorët që ndikon në formimin e tyre; Tregon në hartë me ndihmën e TIK drejtimin dhe rrugën që ndjekin rrymat oqeanike.

Niveli 4

Nxënësi:

- Diferencon llojet e lëvizjeve të ujërave të deteve dhe oqeanëve dhe faktorët që ndikojnë në formimin e tyre; Interpreton në hartë me ndihmën e TIK rrugën dhe drejtimin e lëvizjes së rrymave oqeanike dhe përshkruajnë ndikimin e tyre në klimën e rajoneve ku kalojnë.

Detyrë shtëpie: Nxënësit mbledhin informacion për valët tsunami. Japin argumente si mund të shmangen katastrofa të tilla.

A. Model 2 ore mësimore në lëndën e “Gjeografisë” AMU

Klasa 7

Tema mësimore: Moti

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi:

- Përshkruan elementet e ndryshme të motit dhe instrumentet matës.
- Shpjegon, me shembuj nga jeta e përditshme, rëndësinë e parashikimit të motit.

Situata e të nxënit:

Përmes një kolazhi me foto prezantohen situata të ndryshme të motit. Diskutohet me klasën: Çfarë kupton me shprehjet: “mot i mirë” dhe “mot i keq”? A mund të përcaktosh gjendjen e motit në këtë moment?

Fjalë kyçe: Mot, Element i motit, Temperaturë e ajrit, Elemente të erës, Sasia e reshjeve, Ndryshim i motit, Meteorologji, Hartë meteorologjike, Stacion meteorologjik.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, harta sinoptike të Evropës e të Shqipërisë, instrumente matës të elementëve të motit, tabela me parashikime ditore e javore të motit, pamje e fotografi me ngjyra etj.

Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare: Matematika, Fizika.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:

Organizimi i orës së mësimi:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Klasa organizohet në grupe të vogla pune, dhe secilit grup i kërkohet që për pak minuta të shkruajnë në një letër se çfarë kuptojnë me termat: “mot i mirë” dhe “mot i keq”. Mbi bazën e përgjigjeve të nxënësve zhvillohet një diskutim i lirë duke evidentuar mendimet më të

sakta.

Ndërtimi i njohurive të reja

Klasa organizohet të punojë në grupe. Krijohen 3 grupe nxënësish dhe secilit grup udhëzohet të lexojnë, të zbulojnë informacione e të gjykojnë në mënyrë të pavarur e krijuese mbi:

1. Matjen e elementeve të motit dhe përdorimin e instrumenteve përkatës.
2. Njohjen dhe interpretimin e hartave meteorologjike duke iu përgjigjur me shkrim e me gojë pyetjeve: Çfarë paraqet kjo hartë? Si është gjendja e motit në rajonet: veriore, qendrore dhe jugore të vendit tonë? Po në rajonet pranë brigjeve detare? Ku gjenden këto rajone në hartën e Shqipërisë?
3. Rëndësinë e parashikimit të motit dhe analizën e të dhënave duke zhvilluar një bisedë të lirë me ndihmën e pyetjeve: Si do të jetë moti gjatë pesë ditëve? Kur është temperatura më e lartë? Po era më e shpejtë? Çfarë veshjesh e ushqimesh do përdorësh më shumë këto ditë?

Përforcimi:

Diskutim i lirë

- Zhvillohet një përsëritje të shkurtër të ideve kryesore të temës.
- Organizohet një diskutim i lirë me nxënësit për ato që dinë mbi rëndësinë që ka parashikimi i motit duke dhënë edhe shembuj nga përvoja e tyre.
- Zhvillohen veprimtari plotësuese sipas rubrikës: “Mendo në mënyrë kritike”.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për kontributin e dhënë në veprimtaritë në grupe, për pjesëmarrjen në diskutime, zbulimin e fakteve dhe argumentimin e mendimit.


Niveli 2 - Nxënësi:

- Identifikon elementët e motit dhe instrumentet matës.
- Tregon shembuj të parashikimit të motit.

Niveli 3 - Nxënësi:

- Përshkruan elementet e ndryshme të motit dhe instrumentet matës.
- Shpjegon rëndësinë e parashikimit të motit.

Niveli 4 - Nxënësi:

- 
- Përshkruan elementet e ndryshme të motit dhe diferencon instrumentet matës.

Shpjegon, me shembuj nga jeta e përditshme, rëndësinë e parashikimit të motit

Detyrë shtëpie: Detyrë: “Studimi i motit”

Nxënësit në mënyrë të pavarur do të:

- përshkruajnë ecurinë e elementeve të motit për 7 ditë
- evidentojnë ecurinë e elementeve të motit për 7 ditë duke shënuar vlerat përkatëse për secilin elementet.
- analizojnë ecurinë e motit për 7 ditë duke vëzhguar ecurinë e vlerave të elementeve të motit në orare të ndryshme të ditës

Model 3 ore mësimore në lëndën e “Gjeografisë” AML

Klasa 10

Tema mësimore: Tërmetet

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- shpjegon dukurinë e formimit të tërmeteve;
- dallon tipet e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës;
- përshkruan në hartë shpërndarjen gjeografike të tërmeteve, duke përdorur TIK-un;
- diskuton mbi pasojat e tërmeteve përmes shembujve dhe masat për parandalimin e tyre.

Situata e të nxënit:

Tërmeti më i fundit me magnitudë prej 7.8 ballësh që goditi Turqinë dhe Sirinë mëngjesin e datës 6 shkurt 2023, ka të ngjarë të jetë një nga më të mëdhenjtë këtë dekadë, thanë sizmologët, me një thyerje prej më shumë se 100 kilometrash (62 milje) midis blloqeve të Anadollit dhe Arabisë. Rajoni i Anadollit Lindor është një zonë ku ndodhin lëvizje të shtresave shkëmbore. Në to, pllakat e ngurta shkëmbore shtyhen kundër njëra-tjetrës përgjatë një linje prishjeje vertikale, duke krijuar presion derisa njëra më në fund rrëshqet në një lëvizje horizontale, duke u liruar nga tendosja e madhe që mund të shkaktojë një tërmet. Epiqendra e tërmetit ishte rreth 26 kilometra në lindje të qytetit turk Nurdagi, në një thellësi prej rreth 18 kilometrash në Rajonin e Anadollit Lindor. Tërmeti u përhap drejt verilindjes, duke shkaktuar shkatërrime në Turqi dhe Siri.

Fjalë kyçe: Tërmet, tërmet tektonik, tërmet vullkanik, lëkundje, valë sizmike, epiqendër, vatër, sizmograf, shkallë Rihter.

Burimet dhe mjetet mësimore: Teksti i nxënësit, harta e shpërndarjes së tërmeteve në botë, video, fotografi, kompjutera/laptop, video projektor etj.

Lidhja me fushat e tjera dhe/ose me temat ndërkurrikulare:

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve

Mësuesi sjell në vëmendje të nxënësve situatën më të fundit të tërmetit të ndodhur në Turqi dhe Siri. Mësuesi mund ta shoqërojë diskutimin duke prezantuar një video të shkurtër të tërmetit, por duke bërë kujdes të përzgjedhë pamje që nuk shkaktojnë panik te nxënësit. Duke ri sjellë në vëmendje njohuritë që nxënësit kanë për pllakat tektonike dhe lëvizjen e tyre, nxitet diskutimi për shkaqet e tërmetit.

- Cili mendoni është shkaku i tërmetit të ndodhur në Turqi dhe Siri?
- Pse tërmeti është cilësuar i madh?
- Përshkruani disa ndër pasojat?
- Përveç forcës së tërmetit, cilët faktorë të tjerë ndikojnë në pasojat?

Tërmetet janë dukuri natyrore të cilat njihen nga nxënësit si për shkak të njohurive që kanë marrë në klasat e mëparshme, por dhe për faktin se janë dukuri që ndodhin edhe në vendin tonë. Shqipëria është një zonë sizmike aktive. Për këtë arsye vëmendja e nxënësve duhet të përqendrohet te zhvillimi i njohurive dhe aftësive në këndvështrimin hapësinor gjeografik, sikurse dhe te zhvillimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve për mbrojtjen në rastet e situatave emergjente gjatë dhe pas rënies së tërmeteve dhe masat për parandalimin e tyre. *Shënim: Mësuesi bën kujdes për përjetimet emocionale të nxënësve gjatë diskutimit në lidhje me situatën e tërmetit.*


Ndërtimi i njohurive të reja

Pas diskutimit në lidhje me situatën e rastit, zhvillohet një veprimtari e përbashkët. Bazuar dhe në njohuritë paraprake të nxënësve, mësuesi diskuton me nxënësit për klasifikimin e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës.

Më pas mësuesi e ndan klasën në grupe.

Grupi 1: Përcakton në figurën e dhënë epiqendrën e tërmetit, hipoqendrën, valët dhe çarjen e

tokës



Grupi 2:

U jep përgjigje pyetjeve:

- Pse fuqia/forca e tërmetit përbën faktor për pasojat?
- Pse popullata e zonës ku bie tërmeti përbën faktor për pasojat?
- Pse fortësia e llojit të ndërtimit përbën faktor për pasojat?
- Pse koha gjatë së cilës ndodh tërmeti përbën faktor për pasojat?

Grupi 3:

Mësuesi ka shkarkuar paraprakisht në kompjutera/laptop hartën e botës, në të cilën nxënësit duhet të përcaktojnë shpërndarjen gjeografike të zonave sizmike në botë, të diskutojnë në grup rreth kësaj shpërndarje dhe lidhjes së saj me brezat sizmike.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Në këtë fazë, grupet prezantojnë rezultatet e punës në grup, duke plotësuar përgjigjet anëtarët brenda grupit sikurse dhe anëtarët e grupeve të tjera. Mësuesi plotëson dhe saktëson përgjigjet e nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve

Për vlerësimin e nxënësve do të përdoren:

Përgjigjet me gojë, vëzhgimet e drejtpërdrejta gjatë punës në grup dhe individuale, vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri.

Niveli 2:

Nxënësi:

- tregon si krijohen tërmetet;
- identifikon brezat kryesorë të tërmeteve;
- identifikon disa nga tërmetet në botë ose në vendin tonë dhe pasojat e shkaktuara nga to;
- liston masat që duhet të merren për t'u mbrojtur nga tërmetet.

Niveli 3:


Nxënësi:

- përshkruan tërmetet dhe shkaqet e krijimit të tyre;
- evidenton tipet e tërmeteve;
- përcakton në hartën e botës brezat kryesorë të tërmeteve;
- përshkruan masat që duhet të merren për t'u mbrojtur nga tërmetet.

Niveli 4:

Nxënësi:

- shpjegon dukurinë e formimit të tërmeteve;

- 
- diferencon tipet e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës;
 - përdor hartën dhe teknologjinë për të lokalizuar shpërndarjen gjeografike të tërmeteve;
 - diskuton mbi pasojat e tërmeteve përmes shembujve nga vendi e bota, masat për parandalimin e tyre.

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore

Kriteret e vlerësimit të orës mësimore të hapur:

- mbështesin mësuesit e kategorisë së parë të kualifikimit për të planifikuar dhe për të organizuar një orë mësimore sa më cilësore dhe efektive për arritjet e nxënësit;
- i shërbejnë drejtuesit dhe anëtarëve të rrjetit profesional, drejtuesit të shkollës si dhe pjesëmarrësve të tjerë gjatë zhvillimit të orës mësimore të hapur për të gjykuar dhe vlerësuar cilësinë dhe efektivitetin e kësaj ore mësimore;

Zhvillimi i orës së hapur mësimore, diskutimet, komentet, vlerësimet, sugjerimet e kolegëve u krijojnë mundësi të gjithë mësuesve të shkëmbejnë përvoja pozitive dhe të identifikojnë anët pozitive të një ore mësimore cilësore për t'i bërë pjesë të punës së tyre të përditshme.

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur

Kriteret për vlerësimin e orës mësimore të hapur				
Gjithsej 30 pikë				
Përshkruesit	<i>Niveli 1 - Dobët</i>	<i>Niveli 2 – Mjaftueshëm</i>	<i>Niveli 3 – Mirë</i>	<i>Niveli 4 – Shumë mirë</i>
Planifikimi i orës mësimore të hapur (6 pikë)				
Mësuesi ka planifikuar të gjithë	0 pikë	1 pikë	2 pikë	3 pikë
	Mësuesi ka planifikuar orën mësimore pa pasur një koherencë të komponentëve. Rezultatet e të nxënës (RN) nuk bazohen në	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor; ka planifikuar situatë të nxënës, e cila nuk ndikon shumë në	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës, si dhe ka planifikuar organizimin e	Mësuesi ka planifikuar rezultatet e të nxënës sipas programit lëndor, ka planifikuar situatë të nxënës të cilën e ka përdorur si pjesë e

komponentët e orës së mësimi në mënyrë koherente dhe në përmbushje të rezultateve të të nxëniti	<i>programin lëndor dhe mësuesi nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Metodologjia është tradicionale dhe për më tepër nuk lidhet me stilet e të nxëniti. Pyetjet që u drejtohen nxënësve nuk janë sipas niveleve.</i>	<i>përmbushjen e rezultateve të të nxëniti (RN) ose nuk ka planifikuar situatë të nxëni. Organizimi i nxënësve në klasë është tradicional dhe nuk janë lidhur me stilet e të nxëniti, Pyetjet në përgjithësi janë sipas niveleve.</i>	<i>nxënësve. Metodatat teknikat mësimore janë në koherencë me RN, por nuk përputhen me situatën e të nxëniti dhe me stilet e të nxëniti. Mësuesi ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>	<i>metodologjisë së mësimdhënies, ka planifikuar organizimin e nxënësve dhe metodologjinë në koherencë me RN dhe me stilet e të nxëniti, si dhe ka planifikuar pyetje të llojeve të ndryshme sipas niveleve.</i>
Mësuesi ka planifikuar për temën mësimore qasje të reja inovative që lidhen me demonstrimin e kompetencave të të nxëniti gjatë gjithë jetës, krahas kompetencave lëndore	<i>Mësuesi nuk planifikon duke përfshirë qasje të reja inovative dhe zhvillimin e kompetencave kyç të të nxëniti gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje më së shumti tradicionale. Metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të të nxëniti gjatë gjithë jetës.</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij ka qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin e TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Nga ana tjetër metodatat e planifikuara fokusohen më së shumti te konceptet lëndore, duke lënë mënjanë kompetencat kyç të</i>	<i>Mësuesi në planifikimin e tij kujdeset që të planifikojë qasje të reja inovative që lidhen me zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve, me përdorimin TIK dhe me gjithëpërfshirjen në procesin mësimor. Gjithashtu ai kujdeset që nëpërmjet metodave të planifikuara të</i>

			të nxënit gjatë gjithë jetës.	përfshijë edhe rezultate të kompetencave kyç të të nxënit gjatë gjithë jetës.
Mjedisi i të nxënit (6 pikë)				
Mësuesi ka krijuar një klimë pozitive, ku nxënësit trajtohen në mënyrë të barabartë, shprehin lirshëm mendimet e tyre, respektojnë njëri -tjetrin dhe pranojnë mendimin ndryshe.	Mësuesi krijon një mjedis jo miqësor në klasë, ku jo të gjithë nxënësit kanë mundësi për t'u shprehur lirshëm. Gjatë orës së mësimit vetëm disa nxënës përfshihen në veprimtaritë e orës së mësimit për të shprehur mendimet e tyre.	Mësuesi krijon një mjedis tradicional në klasë, ku nxënësit nuk kanë shumë komunikim me njëri-tjetrin. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.	Mësuesi kujdeset që nxënësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të jenë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni, por jo të gjithë ndihen të suksesshëm dhe me besim e vlerësim për veten.	Mësuesi promovon suksesin e çdo nxënësi duke krijuar një klimë pozitive dhe mjedis miqësor, ku të gjithë respektojnë njëri-tjetrin dhe janë tolerantë duke pranuar mendimin ndryshe. Mësuesi ka krijuar një kulturë të nxëni për të gjithë duke nxitur besimin dhe vlerësimin për veten.
Mësuesi angazhon dhe përfshin të gjithë nxënësit	Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku pak nxënës përfshihen. Vetëm disa nxënës nxiten të	Mësuesi organizon orën e mësimit në mënyrë tradicionale, ku jo gjithë nxënësit përfshihen dhe angazhohen. Vetëm disa	Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen, por nuk i nxit ata me detyra motivuese duke i lënë disi	Mësuesi organizon orën e mësimit duke u kujdesur që të gjithë nxënësit të përfshihen dhe angazhohen me detyra motivuese dhe i nxit ata të ndërmarrin

duke i nxitur dhe motivuar të ndërmarrin iniciativa, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.	<i>marrin pjesë në mësim, të tjerët nuk nxiten me detyra motivuese. Mësuesi nuk u kushton vëmendje të gjithëve lidhur me pyetjet që ata i drejtojnë gjatë orës së mësimit.</i>	<i>nxënës nxiten të marrin pjesë në mësim dhe të ndërmarrin iniciativa. Ai u kushton vëmendje, por nuk i jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>pasivë. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje, por nuk u jep mundësi të gjithëve të marrin një përgjigje.</i>	<i>iniciativa. Ai i kushton vëmendje kur ata shprehin mendimet e tyre, i dëgjon me vëmendje dhe u jep përgjigje me kujdes.</i>
---	--	---	---	--

Metodat mësimore (6 pikë)

Mësuesi përdor metoda që nxisin mendimin kritik, krijues, që nxisin diskutimin (apo debatin), si dhe mendimin ndryshe.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri në përdorimin e metodave të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore mësimi fokusohet më shumti te të mësuarit mekanik e riprodhues dhe nuk nxiten shprehitë e të menduarit në mënyrë kritike.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për metoda të ndryshme gjatë orës së mësimit duke u fokusuar më shumti vetëm te ato tradicionale. Gjatë zhvillimit të orës mësimore vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë apo të demonstrojnë shprehitë e mendimit kritik.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për disa metoda të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor ndonjë metodë apo teknika që nxit mendimin kritik, krijues të nxënësit, por vetëm disa nxënësve u jep mundësi të diskutojnë në këto metoda.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies, gjatë zhvillimit të orës mësimore përdor metoda dhe teknika që nxisin mendimin kritik, krijues të nxënësit, që nxisin diskutimin (apo debatin) dhe i jep mundësi të gjithë nxënësve të përfshihen në këto metoda.</i>
---	---	---	---	---

Mësuesi drejton pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme dhe nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit.	<i>Mësuesi demonstroi që nuk ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Gjithashtu pyetjet i drejton vetëm mësuesi dhe nuk nxit nxënësit të bëjnë pyetje..</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri të kufizuara për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai nuk përdor pyetje të llojeve të ndryshme dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai përdor lloje të kufizuara pyetjesh dhe jo për të gjitha nivelet. Gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit por nuk i jep mundësi nxënësve të përgjigjen vetë.</i>	<i>Mësuesi demonstroi që ka njohuri shumë të mira për nivelet dhe llojet e pyetjeve. Ai i përdor këto gjatë gjithë orës mësimore dhe gjithashtu nxit nxënësit të bëjnë pyetje gjatë orës së mësimit dhe njëri – tjetrit.</i>

Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve (6 pikë)

Mësuesi vlerëson për të identifikuar	<i>Mësuesi përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e tij në orën e mësimit. Mësuesi përdor disa teknika vlerësimi, por nuk përdor nivelet e arritjes për të vlerësuar përmbushjen e rezultateve të të</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Mësuesi përdor vlerësimin nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin e nxënësit për të matur vetëm arritjet e nxënësit duke identifikuar</i>	<i>Mësuesi demonstroi se përdor vlerësimin e nxënësit për të mbledhur informacion lidhur me rezultatet në vijim të nxënësit. Ai përdor vlerësimin për identifikuar pikat e forta të tij si dhe nevojat për përmirësim të nxënësit duke e</i>

nevojat për përmirësim të nxënësit dhe lehtëson procesin e nxënies së tij duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes.	<i>nxënit të orës mësimore.</i>	<i>në orën e mësimi. Mësuesi përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>nevojat për përmirësim të tij. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, bazuar në rezultatet e të nxënit të orës mësimore dhe në nivelet e arritjes.</i>	<i>mbështetur dhe lehtësuar në procesin e nxënies së nxënësit. Mësuesi demonstroi se ka njohuri dhe përdor teknika të ndryshme vlerësimi, vetëvlerësimi apo vlerësimi të nxënësve nga nxënësit, sipas niveleve të arritjes mbështetur në rezultatet e të nxënit të orës mësimore.</i>
Mësuesi angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të nxënësve.	<i>Mësuesi jep detyra për të gjithë nxënësit njësoj, pa marrë parasysh stilet e të nxënit apo nevojat e nxënësve.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon vetëm disa nxënës me detyra të diferencuara.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve, angazhon nxënësit me detyra të diferencuara bazuar në nevojat e tyre.</i>	<i>Mësuesi demonstroi se një nevojat e nxënësve dhe angazhon nxënësit me detyra të diferencuara sipas stileve të të nxënit dhe nevojave të tyre.</i>
Përdorimi i mjeteve didaktike dhe digjitale (6 pikë)				
	<i>Mësuesi nuk përdor mjete mësimore</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjetet mësimore</i>	<i>Mësuesi ka krijuar mjete mësimore didaktike dhe i</i>

Mësuesi përdor mjetet mësimore didaktike për temën mësimore	<i>didaktike për arritjen e rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>didaktike, të cilat janë të kufizuara për zhvillimin e plotë të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>didaktike të përshtatshme në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nuk angazhon shumë nxënës në përdorimin e tyre.</i>	<i>përdor ato në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore duke vënë edhe nxënës në përdorim të tyre në mënyrë që të nxënësit të mësojnë praktik dhe krijojnë.</i>
Mësuesi përdor mjete digjitale për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve	<i>Mësuesi nuk përdor mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor me ndihmën e të tjerëve mjete digjitale por përmbajtja nuk lidhet shumë me rezultatet e të nxënësve të temës mësimore.</i>	<i>Mësuesi përdor vetë mjete digjitale në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore, por nxënës nuk angazhohen në përdorimin e TIK-ut.</i>	<i>Mësuesi përdor mjete digjitale dhe angazhon nxënës në kryerjen e veprimtarive që kërkojnë përdorimin e TIK-ut, në përmbushje të rezultateve të të nxënësve të temës mësimore dhe për të zhvilluar aftësitë digjitale të nxënësve.</i>

Përmbajtja e programit orientues për projektin kurrikular


Projektet kurrikulare kërkojnë që nxënësit të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin mësimor. Ata bëhen nxënës aktivë që marrin pronësinë e arsimimit të tyre, kryejnë kërkime, analizojnë të dhënat dhe zbatojnë njohuritë e tyre në situata të botës reale. Nxënësit mund të shohin rëndësinë dhe praktikitetin e asaj që po mësojnë ndërsa trajtojnë problemet nga jeta praktike, eksplorojnë tema me interes personal ose adresojnë çështje të komunitetit.

Projektet kurrikulare përfshijnë integrimin e njohurive dhe aftësive nga fusha të shumta lëndore, duke i lejuar nxënësit të krijojnë lidhje dhe të shohin ndërlidhjen e disiplinave të ndryshme. Në projekte, nxënësit punojnë në ekipe, duke ndarë idetë, perspektivat dhe ekspertizën. Ata angazhohen në aftësi të menduarit të nivelit më të lartë, të tilla si aplikimi i njohurive, sintetizimi i informacionit dhe marrja e vendimeve. Kjo promovon zhvillimin kognitiv dhe përgatit nxënësit për sfida përtej klasës.

- *Projekti kurrikular shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor, pra në të tri periudhat.*
- *Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në vëmendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.*
- *Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje për çdo grup dhe nxënës (është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara); të paraqesë rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit; të paraqesë hollësisht çdo fazë të realizimit të projektit; të qartësojë nxënësit për arritjen përfundimtare të projektit; të qartësojë nxënësit për kriteret e vlerësimit të projektit; të vëzhgojë dhe të japë gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.*
- *Për procesin e kualifikimit mësuesi organizon prezantimin e produkteve të nxënësve gjatë zhvillimit të projektit kurrikular.*

Statet kryesore që ndiqen për realizimin e projektit kurrikular janë:

- Përcaktohet çështja ose problemi për të cilin do të hulumtohet, në mënyrë që të jetë i menaxhueshëm në kohë.
- Përcaktohen detyrat që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.

- 
- Grumbullohet materiali dhe/ose mjetet e nevojshme.
 - Përpunohen dhe analizohen të dhënat e grumbulluara.
 - Nxirren përfundime dhe përgjithësime nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
 - Prezantohen gjetjet dhe përfundimet e projektit ose prezantohet produkti i krijuar.

Modele të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

A. Model 1 i një projekti kurrikular për nxënësit

Tema e projektit: Ndërhyrjet në mjedis dhe pasojat e tyre

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 6 orë. Projekti do të zhvillohet përgjatë gjithë vitit, me nga 2 orë në secilën periudhë.

Klasat pjesëmarrëse: Klasat e 9-ta

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- analizon faktorët dhe pasojat që sjellin ndërhyrjet e njeriut në mjedisin natyror dhe atë të ndërtuar në rajonin (qytetin/fshatin) e tij;
- paraqet në formë të ndryshme (me gojë, të shkruar) argumente për të përforcuar mendimin apo qëndrimin e vet për problemet mjedisore të identifikuara;
- realizon vëzhgime në rajonin (qytetin/fshatin) ku jeton të peizazhit natyror, objekteve të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të kërcënuara nga ndërhyrjet në mjedis;
- realizon individualisht ose në grup intervista, biseda me specialistë mbi rreziqet me të cilat ekspozohet mjedisi natyror, objektet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si pasojë e ndryshimeve mjedisore;
- kërkon në burime të ndryshme informacioni, mbledh informacion dhe prezanton informacionin e përpunuar me anë të tabelave, diagrameve, grafikëve, tekstit të shkruar etj.;
- përgatit një plan veprimtarish/masash për nxënësit e shkollës/ klasës së tij, të cilat do të ndikojnë sadopak në lehtësimin e pasojave negative të ndërhyrjes së njeriut në mjedis;
- bashkëpunon dhe ndan ide me shokët për realizimin e projektit.

Njohuritë kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

Mjedisi natyror, mjedisi i ndërtuar, rajoni, veçoritë e rajonit, marrëdhënia njeri-mjedisi, trashëgimia natyrore, trashëgimia kulturore, ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Partnerët: Një specialist i mjedisit, një specialist i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Veprimtaritë kryesore

Për realizimin e projektit, klasa ndahet në tre grupe të cilat përcaktojnë nga një tematikë specifike për hulumtim. Grupet, në bashkëpunim me mësuesin, vendosin në lidhje me tematikën për të cilën do të zhvillojnë projektin. Për shembull:

Grupi 1: Ndërhyrjet e njeriut në mjedis: e zhvillojnë apo e dëmtojnë mjedisin?

Grupi 2: Ndërhyrjet tona në mjedis dhe peizazhi natyror.

Grupi 3: Ndërhyrjet tona në mjedis dhe trashëgimia natyrore dhe kulturore.

Nr	Veprimtaria	Afati	Produkti i punës
1	- Përcaktimi i temës dhe nën temave të projektit në bashkëpunim me nxënësit. - Përcaktimi i detyrave për secilin grup dhe nxënës. - Përcaktimi i afateve për secilën fazë të projektit. - Hartimi i një liste paraprake të burimeve të informacionit të cilët do të mbështesin studimin. - Përgatitja e pyetësorëve dhe intervistave të strukturuar.	Periudha e parë Shtator-dhjetor Faza e parë e projektit	<u>Produkti:</u> - Hartimi dhe dorëzimi nga çdo nxënës i dokumentit që pasqyron: <i>Temën e grupit, nën çështjen individuale, burimet e informacionit ku do mbështetet dhe hapat për fazat pasardhëse.</i> - Pyetësorët e përgatitur sipas tematikave të grupeve.
2	- Mbledhja e informacionit nga pyetësorët, intervistat dhe përmes hulumtimit në burimet e identifikuar të informacionit. - Përpunimi i të dhënave.	Periudha e dytë Janar-mars Faza e dytë e projektit	<u>Produkti:</u> Drafti i parë i projektit.

	Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.		
3	- Përgatitja e produktit përfundimtar. - Prezantimi nga grupet. - Vlerësimi i punës në grup dhe punës individuale	Periudha e tretë Prill-qershor Faza e tretë e projektit	<u>Produkti:</u> Produkti përfundimtar në formën e një raporti.

Burimet kryesore të informacionit:


Hartë fizike dhe politike e Shqipërisë, materiale të nxjerra nga faqe web të internetit, enciklopedi, revista mjedisore, vëzhgime në terren, foto, video etj.

Përshkrimi i produktit përfundimtar të projektit:

Secili grup do të realizojë punën e tij në formën e një raporti.

Raporti për secilin grup duhet të përfshijë:

- të dhëna sasiore (ku është e nevojshme) dhe cilësore të dala nga hulumtimi në burimet e përcaktuara si dhe nga intervistat dhe pyetësorët e realizuar, të cilat mbështesin trajtimin e tematikës përkatëse të grupit;
- foto, pamje dhe ilustrime nga vëzhgimet në terren dhe/ose nga burime të tjera që shoqërojnë të dhënat, si p.sh., hartë e zonës, pamje nga Google etj.;
- secili grup në varësi të tematikës, duhet të përfshijë në produkt një plan aktivitetesh në nivel klase/shkolle për zbutjen e pasojave të problemit dhe menaxhimin e situatës për të ndërgjegjësuar nxënësit e tjerë të shkollës dhe komunitetin (të shprehur në formë skematike/narrative);
- raporti mund të prezantohet në Power point/në formë poster/në fletë A4 me shkrim ose në word.



Tematika e orëve të planifikuara

1. Ndarja e detyrave për secilin nxënës dhe përcaktimi i burimeve të informacionit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit për secilin grup, afatet dhe personi përgjegjës.
2. Përgatitja e instrumenteve (pyetësorë, intervista) për grumbullimin e informacionit në terren.
3. Grumbullimi i të dhënave nga intervistat dhe burimet e tjera të informacionit.
4. Përpunimi i të dhënave. Diskutimi në klasë i rezultateve kryesore paraprake të nxënësve.
5. Përgatitja e draftit të parë të projektit dhe diskutimi në klasë.
6. Prezantimi i produktit/raportit përfundimtar. Vlerësimi i punës në grup dhe individuale.

B. Model 2 i një projekti kurrikular për nxënësit

Projekt kurrikular

Tema e projektit: Turizmi në Shqipëri dhe potencialet për zhvillimin e tij

Kohëzgjatja e projektit/orët mësimore: 6 orë. Projekti do të zhvillohet përgjatë gjithë vitit, me nga 2 orë në secilën periudhë.

Klasat pjesëmarrëse: Klasat e 11-ta

Rezultatet e të nxënit

Nxënësi:

- vlerëson rolin dhe rëndësinë e pozitës gjeografike të Shqipërisë për zhvillimin e turizmit;
- analizon potencialet natyrorë dhe humanë që mundësojnë zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në Shqipëri;
- evidenton disa ndër problematikat që ndikojnë në zhvillimin e turizmit në Shqipëri;
- parashikon rrugë dhe strategji të zhvillimit të llojeve të ndryshme të turizmit dhe promovimit të zonave turistike në vendin tonë;
- krahason të paktën tre burime të ndryshme të informimit për trajtimin e temës, argumenton saktësinë, rrethanat, gjen ngjashmëritë dhe dallimet, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara më parë;
- prezanton gjetjet kryesore para të tjerëve në forma të ndryshme shprehëse (me shkrim dhe me gojë), duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- demonstroi bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup.

Njohuritë kryesore që do të përdoren gjatë zhvillimit të projektit:

Mjedisi natyror, mjedisi human, rajoni, veçoritë e rajonit, marrëdhënia njeri-mjedisi, trashëgimia natyrore, trashëgimia kulturore, ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, turizmi, llojet e turizmit, zonat turistike.

Partnerët: Specialistë të turizmit, gjeografë dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit.

Veprimtaritë kryesore

Për realizimin e projektit, klasa ndahet në katër grupe të cilat përcaktojnë nga një tematikë specifike për hulumtim. Grupet, në bashkëpunim me mësuesin, vendosin në lidhje me tematikën për të cilën do të zhvillojnë projektin. Për shembull:

Grupi i parë: Turizmi malor (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit)

Grupi i dytë: Turizmi bregdetar (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit)

Grupi i tretë: Turizmi kulturor (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit)

Grupi i katërt: Agroturizmi (Potencialet natyrore dhe humane, problematikat, zonat turistike, rrugë dhe mundësi të zhvillimit).

Nr.	Veprimtaria	Afati	Produkti i punës
1	- Përcaktimi i temës dhe nën temave të projektit në bashkëpunim me nxënësit. - Përcaktimi i detyrave për secilin grup dhe nxënësi. - Përcaktimi i afateve për secilën fazë të projektit. - Hartimi i një liste paraprake të burimeve të informacionit të cilët do të mbështesin studimin. - Përgatitja e pyetësorëve/ intervistave të strukturuar.	Periudha e parë (Shtator-Dhjetor)	- Hartimi dhe dorëzimi nga çdo nxënësi i dokumentit që pasqyron: <i>Temën e grupit, nën çështjen individuale, burimet e informacionit ku do mbështetet dhe hapat për fazat pasardhëse.</i> - Pyetësorët e përgatitur sipas tematikave të grupeve.

2	- Mbledhja e informacionit nga pyetësorët, intervistat, dhe përmes hulumtimit në burimet e identifikuara të informacionit. - Përpunimi i të dhënave. Hartimi i draftit të parë të projektit dhe diskutimi i tij.	Periudha e dytë (Janar-Mars)	Produkti: Drafti i parë i projektit.
3	- Përgatitja e produktit përfundimtar. - Prezantimi nga grupet. - Vlerësimi i punës në grup dhe punës individuale	Periudha e tretë (Prill-Qershor)	Produkti: Produkti përfundimtar në formën e një raporti

Burimet kryesore të informacionit:


Teksti i nxënësit, enciklopedi, revista, fletëpalosje, guida turistike, harta, adresa të ndryshme interneti, biseda me specialistë të fushave të ndryshme ku mund të grumbullohen të dhëna, vëzhgime në terren, video/CD etj.

Përshkrimi i produktit përfundimtar të projektit:

Secili grup do të realizojë punën e tij në formën e një raporti.

Raporti për secilin grup duhet të përfshijë:

- Të dhëna sasiore (ku është e nevojshme) dhe cilësore të dala nga hulumtimi në burimet e përcaktuara si dhe nga intervistat dhe pyetësorët e realizuar, të cilat mbështesin trajtimin e tematikës përkatëse të grupit.
- Foto, pamje dhe ilustrime nga vëzhgimet në terren dhe/ose nga burime të tjera që shoqërojnë të dhënat, si p.sh. hartë e zonës, pamje nga Google etj.
- Secili grup në varësi të tematikës, duhet të përfshijë në produkt një plan strategjik masash që mund të merren për nxitjen e turizmit (të shprehur në formë skematike/narrative).

- 
- Raporti mund të prezantohet në Power point/në formë posteri/në fletë A4 me shkrim ose në word.

Tematika e orëve të planifikuara

1. Ndarja e detyrave për secilin nxënës dhe përcaktimi i burimeve të informacionit. Hartimi i planit të veprimtarive të projektit për secilin grup, afatet dhe personi përgjegjës.
2. Përgatitja e instrumenteve (pyetësorë, intervista etj.) për grumbullimin e informacionit në terren.
3. Grumbullimi i të dhënave nga intervistat dhe burimet e tjera të informacionit.
4. Përpunimi i të dhënave. Diskutimi në klasë i rezultateve kryesore paraprake të nxënësve.
5. Përgatitja e draftit të parë të projektit dhe diskutimi në klasë.
6. Prezantimi i produktit/raportit përfundimtar. Vlerësimi i punës në grup dhe individuale.

Kriteret e vlerësimit të projekteve kurrikulare për nxënësit në AMU dhe AML

Model instrument i vlerësimit të projektit kurrikular

Kriteret për vlerësimin e projektit kurrikular vjetor				
Gjithsej 40 pikë				
<i>Kriteret e vlerësimit</i>	<i>Niveli 1 – Dobët</i>	<i>Niveli 2 – Mjaftueshëm</i>	<i>Niveli 3 – Mirë</i>	<i>Niveli 4 – Shumë mirë</i>
	0-2 pikë	3-6 pikë	7-9 pikë	10-12 pikë
Aftësitë kërkimore/hulumtuese. Demonstrimi i tyre (12 pikë)	Nxënësit rrallëherë përqendrohen te detyra e tyre. Ata mbledhin informacione pa gjetur zgjidhje të përshtatshme.	Nxënësit dalin jashtë temës dhe nuk përqendrohen vetëm te detyra e tyre. Ata mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje me ndihmë. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre shumicën e kohës. Ara mbledhin informacion dhe gjejnë zgjidhje standarde. Nxënësit përdorin të paktën dy burime të ndryshme për të gjetur informacione.	Nxënësit përqendrohen te detyra e tyre. Ata orientohen dhe vetëdrejtohen shumë mirë. Nxënësit mbledhin informacion në mënyrë aktive dhe komentojnë për të zgjidhur probleme. Nxënësit përdorin shumëllojshmëri informacionesh.
Analiza dhe interpretimi i të dhënave,	0-2 pikë	3-5 pikë	6-8 pikë	9-10 pikë
	Nxënësit rrallëherë	Nxënësit ndonjëherë	Nxënësit zakonisht	Nxënësit përdorin gjatë gjithë

fakteve, ngjarjeve etj. Zgjedhja dhe zbatimi i teknikave të përshtatshme (10 pikë)	<i>përdorin teknika të përshtatshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban shumë gabime.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme, por jo në mënyrë të vazhdueshme. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban disa gabime të rëndësishme.</i>	<i>përdorin teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja përmban pak gabime.</i>	<i>projektit teknika të përshtatshme dhe efektive. Analiza, interpretimi, zgjidhja nuk përmban gabime.</i>
Aftësitë e prezantimit: Prezanton në mënyrë efektive rezultatet e projektit (18 pikë)	0-5 pikë <i>Në prezantimin e nxënësve materiali është i çorganizuar dhe rrëmujë. Është e vështirë të kuptosh cilat informacione shkojnë me njëri -tjetrin.</i> <i>Prezantohen shumë pak rezultate të projektit.</i>	6 -9 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë mirë punën e tyre.</i> <i>Prezantimi jo gjithmonë të krijon lehtësi dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Prezantohen vetëm disa rezultate të projektit.</i>	10-14 pikë <i>Në prezantimin e tyre nxënësit organizojnë mirë punën e tyre që në shumicën e kohës të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Në përgjithësi prezantohen rezultatet e projektit.</i>	15-18 pikë <i>Në prezantimin e tyre, nxënësit organizojnë shumë mirë punën e tyre që të krijon lehtësi leximi, dëgjimi dhe të kuptuari.</i> <i>Rezultatet e projektit prezantohen qartë.</i>



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

